

SHPALLJA E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS

Tabela .1

Nr.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Proçedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Intervista	Fillimi	Mbarimi
1	Specialist IT	Reparti Ushtarak Nr. 2002	Durres	Kontratë pune me afat të pacaktuar	Me dosje		01.09.2022	14.09.2022

Formulari nr. 1

1.Pozicioni i punës: Specialist IT.
2. Kodi i pozicionit: Kod vendodhje B-002, Kod grupi C, paragrafi 02, numër rendor 008 dhe specialitet ND3426
3. Reparti Ushtarak Nr. 2002 Kompania e Shtabit në Forcën Detare
4. Vendi: Plepa Durres
5. Paga: 36.500 (Tridhjetë e gjashtë mijë e pesëqind) lekë
6. Lloji i kontratës së punës: Kontratë me afat të pa caktuar
7. Data e fillimit të aplikimit: 01.09.2022
8. Data e mbylljes së aplikimit: 14.09.2022
9. Mënyra e aplikimit: Për të aplikuar kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit, të cilin do ta gjejnë në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes në adresën www.mod.gov.al . Formulari pasi plotësohet, së bashku me dokumentacionin përkatës, do t'i dërgohet Komandës së Forcës Detare, brenda afatit të caktuar, në

zarf, dorazi ose në rrugë postare në adresën:

Komanda e Forcës Detare Plepa Durrës

10. Dokumentet e aplikimit:

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- kërkesën;
- formularin e aplikimit;
- fotokopje të kartës së identitetit;
- diplomën e shkollës së mesme/parauniversitare ose të lartë të noterizuar ose në origjinal;
- fotokopje të patentës nëse ka;
- dëshmi profesioni nëse ka;
- certifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja;
- raport mjekësor;
- fotografi me përmasa 4x6, 2 copë;
- dëshmi penaliteti;
- vërtetim nga gjykata;
- vërtetim nga prokuroria;
- librezë pune;
- jetëshkrimin (CV).
- formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM-së në adresën elektronike [ëëë. mod.gov.al](http://eëë.mod.gov.al). (linku: *Baza ligjore/Akte ligjore/ Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i vetdeklarimit*)

11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:

- a) të ketë shtetësinë shqiptare;
- b) të jetë jo më pak se 18 vjeç;
- c) të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- d) të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kriterëve të miratuara;
- ç) të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore;

- e) të mos jetë të dënuar me burg me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerje të një krimi;
dh) të mos ketë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- a. Grada/Titulli: Civil
- b. Arsimi : I Mesëm/larte
- c. Kualifikimi: Diplomën e shkollës së mesme/lartë dhe listë notash, të noterizuar ose në origjinal ose profesionale për IT.
- d. Trajnimi: Kurse dhe kualifikime të ndryshme civile dhe ushtarake për formimin e përgjithshëm dhe atë profesional që i përshtatet pozicionit të punës
- e. Eksperiencia në Punë: Preferohet me eksperiencë pune në sistemin e informatikës
- f. Gjuha e huaj: Preferohet anglisht.
- g. Kërkesa të tjera specifike: Të jetë i/e aftë të bashkëpunojë në grup.
- h. Niveli i certifikatës së sigurisë: - Sekret

13. Përshkrimi i punës:

Specialisti për IT punon për zgjidhjen e problemeve të rrjetit të internetit dhe mirëmbajtjen e institucionit të FD-së. Suportimin në realizimin e stërvitjeve në ambjentet e FD

Përgjigjet për zbatimin e politikave të përcaktuara në fushën e ndërlidhjes, sektorët e informatizimit, teknikës së informacionit dhe simeve të telekomunikacionit në Forcën Detare. Është përgjigjës për politikën e përgjithshme të implementimit dhe informatizimit të sistemeve It, programimit, monitorimit të projekteve dhe teknikës si dhe për hartimin e strategjive të IT-së në sektorë të ndryshëm arsimorë dhe stërvitor sipas standarteve bashkëkohore të sistemeve elektronike të aplikuara në Forcën Detare

14. Detyrat kryesore:

- Administrimi dhe mirëmbajtja e sistemit të informacionit.
- Administrimi dhe mirëmbajtja e rrjeteve kompjuterike (LAN/WAN)
- Administrimi dhe mirëmbajtja hardware dhe sotwareb e gjithë komponentëve të rrjetit kompjuterik.

- Trajnimi periodik i gjithë përdoruesve fundorë të rrjetit kopjuterik.
- Zbatimi i masave të sigurisë teknike të informacionit.
- Administrimi i sistemit të informacionit në KFD
- Organizimi në ngritjen tekniko-profesionale të personelit teknik të sistemit kompjuterik në FD
- Kontrolli i gadishmërisë teknike të sistemit kompjuterik në qendrën e serverave. Ushtrimi i kontrollit periodik për problemet e administrimit, programimit, të ruajtjes dhe mirëmbajtjes së informacionit në qendrën e serverave

Përgjegjesi të tjera

- Mund të kryejë detyratë tjera në përshtatje me nevojat e shërbimit
- Puna kryhet zakonisht në zyrë në kushte normale pune

15. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3 (tre) veta.

Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- përzgjedhjen paraprake;
- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;
-

Konkurimi me kandidatët që plotësonë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse;

Vlerësimi i tyre do të bëhet nga komisioni përkatës.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen:

- a. 40 pikë, për vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve;
- b. 60 pikë, për intervistën e strukturuar me gojë.

- **Vlerësimi i dokumenteve** të kandidatëve përfshin:

- a. vlerësimin e jetëshkrimit (CV);

- b. vlerësimin e kualifikimeve akademike, profesionale dhe teknike;
- c. vlerësimin e trajnimeve;
- d. vlerësimin e eksperiencave të ngjashme të punës;

- Pikët totale të vlerësimit të dokumenteve ndahen, si më poshtë:
 - a. jetëshkrimi, 5 pikë;
 - b. arsimimi/kualifikimi, 15 pikë;
 - c. trajnimi, 5 pikë;
 - d. eksperiencia/përvoja në punë, 15 pikë.

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.